




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 32, datë 16.11.2023

PËR



**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SUBJEKTI “ERDI GAS” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti “Erdi Gas” sh.p.k, sipas Kontratës me Nr. 103 Rep., Nr. 27/3 Kol., datë 16.01.2019 “Për rikonstruksionin/fuqizimin, vënien në punë dhe administrimin e hidrocentralit “Gjinar” me kapacitet prodhues 0.44 MW, në përroin e Gostimës dhe përroin e Gurrthatës, degë të përroit Zalli i Gostimës, degë e lumit Devoll, Bashkia Elbasan, Qarku Elbasan”.



2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

### HEC Gjinar

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujqor Përroi i Gostimës

- X= 515697; Y= 4545296; Z=742 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.28 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.2 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.017 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2/ burimi ujqor Përroi i Gurrthatës

- X= 515653; Y= 4544611; Z=742 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 0.1 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.08 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.007 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 515036; Y= 4544597; Z=586 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 0.38 m<sup>3</sup>/s
- Prodhimi vjetor i parashikuar: E= 1,630,473 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 440 kwh
- Vlera totale e investimit: 75 525 195 l lekë pa TVSH.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

